

LIGJI Nr. 05/L -120

PËR TREPÇËN

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR TREPÇËN

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së asetëve dhe avancimin e kapitalit tekniko teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë transformimin e njësive biznesore të listuara në paragrafin 2 të këtij neni në Shoqëri Aksionare Trepça Sh.A.

2. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A janë:

2.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89);

2.2. Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88);

2.3. Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç (Fi 804/89).

3. Bazuar në studimin e fizibilitetit dhe arsyeshmërinë ekonomike e financiare, në përbërje të Trepça Sh.A. formohen edhe këto njësi biznesore:

3.1. Metalurgjia e Plumbit;

3.2. Metalurgjia e Zinkut;

3.3. Industria Kimike.

4. Bazuar në studimin e fizibilitetit mund të themelohen edhe njësi të tjera biznesore për përpunimin e metaleve, produkteve dhe shërbimeve të tjera.

5. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A. formohen sipas këtij ligji dhe sipas vendimeve të Bordit Mbikëqyrës me propozim të Bordit Menaxhues në bazë të studimit të fizibilitetit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **“Trepça”** - Ndërmarrje Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila është e regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Regjistrim të Biznesit në Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 70331094 si dhe e regjistruar në regjistrat gjyqësorë me emërtimin: Kombinati Xehetaro-Metalurgjik Kimik Trepça, e cila aktualisht e bazuar në certifikatën e regjistrimit identifikohet me emërtimin “Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP”;

1.2. **Trepça Sh.A.** – shoqëri aksionare në pronësi 80% të Qeverisë dhe 20 % të punëtorëve sipas nenit 4 të këtij ligji;

1.3. **Njësi biznesore** - njësitë biznesore të Trepçës, siç janë përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji;

1.4. **Legjislacioni relevant** - përfshin në mënyrë specifike, por pa u kufizuar, Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike (Gazeta Zyrtare, nr. 31, 15 qershor 2008), si dhe Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare, nr. 39, 1 tetor 2008).

1.5. **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** - organin e pavarur publik, i themeluar me ligj, e cila është e autorizuar për administrimin e ndërmarrjeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare, nr. 19 / 21 shtator 2011) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet përkatëse;

1.6. **Ministria** - Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, apo ministrinë pasuese që ka kompetenca për ndërmarrjet publike;

1.7. **Mbetje teknologjike** - mbetjet minerare dhe mbetjet industriale;

1.8. **Dhoma e Posaçme** –Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë e Privatizimit, e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 22 shtator 2011);

1.9. **Partneriteti Publiko Privat ose PPP** - çdo bashkëpunim kontraktues ose institucional në mes të një ose më shumë Autoriteteve Publike dhe një ose më shumë Partnerëve Privatë siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat (Gazeta Zyrtare, nr. 26 / 25 nëntor 2011).

Neni 4 Aksionarët

1. Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të Trepça Sh.A.
2. Pronarë të 20% të aksioneve të Trepça Sh.A. janë punëtorët.
3. Përqindja e pjesëmarrjes në 20% të aksioneve, për secilin punëtor veç e veç, përcaktohet duke e përlogaritur sipas vlerës së aseteve të njësisë biznesore ku punëtori ka marrëdhënie pune.
4. Mënyra e ndarjes së aksioneve të punëtorëve sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni caktohet me akt të veçantë nënligjor.

Neni 5 Resurset Minerale, bartja e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore

1. Resurset Minerale janë pronë e Republikës së Kosovës.
2. Trepça Sh.A. hulumton dhe shfrytëzon resurset minerale në bazë të licencës për hulumtim dhe shfrytëzim të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operuese të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça kalojnë në Trepça Sh.A.
4. Të gjithë punëtorët të cilët kanë kontratë të rregullt pune në njësinë biznesore të definuar me këtë ligj, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë marrëdhënien e punës në njësinë përkatëse biznesore.
5. Trepça Sh.A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit.

KAPITULLI II ORGANIZIMI DHE REGJISTRIMI

Neni 6 Statuti

1. Struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi dhe çështjet tjera organizative specifike të Trepça Sh.A, përcaktohen në statutin e shoqërisë aksionare sipas ligjit.
2. Statuti i Trepça Sh.A propozohet nga Bordi Mbikëqyrës, miratohet nga aksionarët pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës.
3. Asetet e Trepça Sh.A. përbëhen nga asetet e njësisë biznesore të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit dhe me metodat standarde të vlerësimit.

4. Pasuria e Trepçës dhe rezultatet e saj financiare paraqiten në pasqyrat e konsoliduara financiare të Trepça Sh.A.

Neni 7 Regjistrimi

Ministria, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për regjistrimin e Trepça Sh.A. në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

KAPITULLI III QEVERISJA

Neni 8

1. Qeverisja e Trepça Sh.A. bëhet nga:

1.1. Bordi Mbikëqyrës;

1.2. Bordi Menaxhues.

Neni 9 Bordi Mbikëqyrës

1. Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të zgjedhur nga aksionarët përpjesëtimisht me pjesëmarrjen në kapital, sipas procedurave që përcaktohen në statut.

2. Zgjedhja e Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A. bëhet sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës.

3. Në përbërjen e Bordit Mbikëqyrës duhet të sigurohet ekspertiza e nevojshme nga fusha e ekonomisë, gjeoshkencave, drejtësisë, teknike dhe teknologjike si dhe kërkesa specifike të përkufizuara me Statutin e Trepça Sh.A.

4. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës duhet të kenë diplomë universitare nga fushat e cekura në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të kenë përvojë pune së paku dhjetë (10) vjeçare, prej të cilave pesë (5) vite në pozita menaxhuese.

5. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të forumeve të partive politike dhe as të kenë konflikt interesi sipas dispozitave të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe duhet t'i plotësojnë kriteret e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

6. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë të pavarur në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre dhe mandati i tyre zgjat katër (4) vite.

7. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga aksionarët që përfaqësojnë, sipas dispozitave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës.

8. Bordi Mbikëqyrës, përveç kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës, ushtron edhe këto detyra dhe përgjegjësi:

8.1. Zgjedh anëtarët e Bordit Menaxhues të Trepça Sh.A.;

8.2. Aprovon planet financiare dhe zhvillimore të njësive biznesore në kuadër të Trepça Sh.A.;

8.3. Aprovon kontratat lidhur me partneritetin.

9. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, funksionimin dhe shuarjen e njësive biznesore ose investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionari kryesor.

10. Vendimet që nderlidhen me investimet dhe partneritetet për hulumtim dhe shfrytëzim të mineraleve, si dhe transformimin e pronës të Trepçës Sh.A., Bordi Mbikëqyrës mund t'i marrë vetëm pasi të merret miratimi nga Kuvendi i Kosovës.

11. Në punën e vet Bordi Mbikëqyrës udhëhiqet nga parimet e qeverisjes korporative të transparencës, llogaridhënies, efikasitetit dhe efektivitetit, kompetencës profesionale dhe pavarësisë.

12. Bordi Mbikëqyrës mund të themelojë komitete/komisione të përhershme ose të përkohshme nga kompetenca dhe fushëveprimtaria e vet, përfshirë komitetin/komisionin e Auditimit të Brendshëm.

13. Krahas kësaj Bordi Mbikëqyrës do të angazhojë një auditor të jashtëm të pavarur me reputacion ndërkombëtar i cili do të raportojë tek aksionarët lidhur me pasqyrat financiare të njësive biznesore të Trepça Sh.A.

Neni 10

Bordi Menaxhues

1. Bordi Menaxhues, përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A., Zëvendësi i tij dhe udhëheqësit e njësive biznesore.

2. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Menaxhues përcaktohen me Statutin e Trepça Sh.A.

KAPITULLI IV

NJËSITË BIZNESORE

Neni 11

1. Njësiti biznesore do të kenë nënlogari të veta evidentuese dhe kompetenca për të menaxhuar operacionet e veta dhe për të marrë vendime lidhur me pagat dhe shpenzimet operative sipas planeve financiare të aprovuara nga Bordi Mbikëqyrës.

2. Njësitë biznesore mund të propozojnë planet, projektet investuese në të cilat do të mund të investojnë fitimin e tyre dhe inkuadrojnë iniciativa për partneritetin publiko-privat ose investuesve privatë me aprovim në Bordin Mbikëqyrës.
3. Dividendi që u takon aksionarëve sipas pjesëmarrjes së tyre në aksione evidentohet dhe paguhet në nivel të njësisë biznesore duke u bazuar në rezultatin financiar të saj.
4. Mënyra e funksionimit të njësive biznesore rregullohet me Statutin e Trepça Sh.A.

KAPITULLI V MUNDËSITË E PJESËMARRJES SË SEKTORIT PRIVAT

Neni 12

1. Trepça Sh.A. në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj do të krijojë mundësi për të qenë atraktive për investues privatë vendorë dhe të jashtëm, në format si:

- 1.1. partneriteti publiko-privat;
- 1.2. investime direkte private;
- 1.3. investime të përbashkëta;
- 1.4. emetimi dhe shitja e aksioneve.

2. Investimet në njësitë ekzistuese qeverisen sipas pjesëmarrjes në kapital.

3. Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. mund të vendosë aranzhmane kontraktuale për qeverisjen dhe menaxhimin në njësitë përkatëse biznesore edhe kur pjesëmarrja e investitorit privat në kapital është më e vogël se 50%.

4. Në rast se investitori privat krijon një pjesëmarrje më të madhe se 50% në njësinë biznesore, qeverisja dhe organizimi i entitetit biznesor bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

5. Për investimet në metalurgji dhe në përpunim të metaleve si dhe në industrinë kimike, Qeveria e Republikës së Kosovës, si aksionari kryesor, dhe investitorët privatë mund të formojnë kompani që mbetet në një aleancë dhe partneritet strategjik me Trepça Sh.A. Partneriteti strategjik ndërtohet për bashkëpunim afarist lidhur me furnizimin me koncentrat të mineraleve të eksploatuara nga njësitë përkatëse të Trepça Sh.A.

6. Në bazë të studimit të fizibilitetit, partneriteti strategjik mund të lidhet në interes për zhvillimin e metalurgjisë, përpunim të metaleve në Kosovë dhe gjithashtu edhe për shfrytëzim të metaleve të rralla e të çmuara, zhvillim të industrisë kimike dhe produkte e shërbime të tjera që gjenerojnë punësim në Kosovë.

7. Trepça Sh.A. mund të regjistrohet në bursat e tregut të letrave me vlerë me qëllim të sigurimit të burimeve për investime të reja.

KAPITULLI VI PËRGJEGJËSIA SOCIALE DHE RAPORTI ME KOMUNITETIN

Neni 13

1. Trepça Sh.A. dhe njësitë e saj do të qeverisen me parimin e përgjegjësisë sociale duke i kontribuar zhvillimit të komunitetit.
2. Pas inkasimit të rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës ku ndodhet njësia biznesore, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësia biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sport, shëndetësi dhe arsim.

KAPITULLI VII PJESËT TJERA TË NSH “TREPÇA”

Neni 14

1. Asetet tjera të ndërmarrjes shoqërore “Trepça”, të cilat nuk transformohen me këtë ligj në Trepça Sh.A., do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Asetet jothelbësore dhe joprofitabile do të mbeten në menaxhim të AKP-së për t’iu nënshtruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me ligjin.
2. AKP duhet t’i ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për t’i realizuar të drejtat e Kosovës dhe të Trepçës lidhur me asetet e Trepçës në vendet e tjera.

KAPITULLI VIII PRETENDIMET E KREDITORËVE

Neni 15

1. Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/-L-035 për riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça SH.A. do të trajtohen në përputhje me ligjin për Ndërmarrjet Publike.

KAPITULLI IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Në qoftë se para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë filluar procedura të riorganizimit, falimentimit apo likuidimit, lidhur me njësitë organizative të NSH. "Trepça" nga neni 2 i këtij ligji, ato ndërpriten me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 17

Dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi çdo dispozitë tjetër të legjislacionit tjetër që mund të parasheh diçka ndryshe prej asaj që parashihet me këtë ligj.

Neni 18

Qeveria, me propozimin e Ministrisë, miraton aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda gjashtë (6) muaj nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -120

8 tetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2016, datë 31.10.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.